



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për tremujorin e tretë 2020

Oda e Mjekëve të Kosovës



Tetor 2020

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për tremujorin e tretë 2020	1
1. Këshilli Drejtues.....	3
2. Anëtarësimi	4
3. Mbikëqyrja etiko-profesionale	5
4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	6
5. Licencimet	6
6. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të	7
7. Këshilli Mbikëqyrës	7
8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	7
9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke	7
10. Raporti financiar.....	8
10.1 Gjendja financiare – 30 shtator 2020	8
10.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	9
10.3 Prokurimi	9
11. Aktivitete të tjera	9
11.1 Shërbimi profesional.....	9
11.2 Kongresi vjetor	9
11.3 Revista mjekësore e Odës së Mjekëve të Kosovës	10
11.4 Marrëdhënie ndërkombëtare.....	10
11.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	10
12. Plani i veprimit për 2020.....	11

1. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore korrik–shtator 2020, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur gjashtë (6) takime, ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM3	Vendimet sipas kërkesave/ankesave së pranuar për periudhën TM3	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën TM3	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	8	4	3	<p>1- Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit për tenderin për përkthim dhe lektorim të dokumenteve të OMK-së;</p> <p>2-Vendim për inicimin e procedurës së rekrutimit për asistent/e administrativ/e;</p> <p>3-Vendim për formimin e komisioneve të zgjedhjes dhe ankesave për asistent/e administrativ/e;</p> <p>4-Vendim për bashkimin e procedurave të aplikimit për licencë;</p> <p>5-Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për blerjen e pajisjeve teknologjike;</p> <p>6-Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit për tenderin për blerjen e pajisjeve teknologjike;</p> <p>7-Vendim për dhurimin e mjeteve financiare për mjekët e vdekur nga Covid19;</p> <p>8-Vendim për angazhimin e dy praktikantëve;</p>	6

Këshilli Drejtues i OMK-së në procedurë të votimit qarkullues me datë 30 korrik ka marr vendim për dhurimin e mjeteve financiare të dedikuara për familjet e mjekëve që kanë vdekur si pasojë e infektimit me virusin Covid 19. Deri me datë 30 shtator janë të infektuar me Covid 19 mbi 1000 punëtorë shëndetësor, ku 700 prej tyre janë mjekë. 8 mjekë kanë vdekur si pasojë e infektimit me Covid 19.

2. Anëtarësimi

Gjatë periudhës korrik-shtator 2020, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 117 mjekë, ku 2 mjekë janë të huaj dhe 115 mjekë vendas (përfshirë 10 mjekë të punësuar në sektorin publik, 9 mjekë të punësuar në sektorin privat, 96 mjekë të pa punë).




Tabela 1.1: Anëtarësimet për periudhën korrik-shtator 2020




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri me datën 30 shtator 2020

Gjatë periudhës korrik-shtator 2020 kanë ndodhur 9 ndërprerje në anëtarësi, është ç'anëtarësuar në mënyrë vullnetare 1 mjek si dhe janë rianëtarësuar 12 mjekë. Numri total i anëtarëve deri me datën 30 shtator është 4559.

3. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM3	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM3	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM3	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM3	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	25	36	///	///	1	20
Këshilli Etik	18	8	Rekomandime kolegjale 1 Qortim Publik 2 Gjoha 1: Gjithesëj : 0 00.00€ Paushalli i procedures: 600€	Qortim publik 0 (00.00€) Gjoha 0 (0.00€) Gjithesëj: 00.00€ Shpenzime te paushallit : 100€	2	18
Gjyqi i Nderit	2	2	1.)Aprovohet ankesa GJN. 05/2020 kundër vendimit të Këshillit Etik KE. 74-29/2020. 2.)Hudhet si e paafatshme ankesa GJN. 06/2020 kundër vendimit të Këshillit Etik KE. 74-29/2020.	///	0	0
Certifikatat e të kaluarës etike	27	///	///	///	///	///

Në shqyrtim të drejtpërdrejtë, janë mbajtur tre seanca e shqyrtimit kryesor, në të cilin është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejt i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë). Ndërkaq në shqyrtime të drejtpërdrejta, janë mbajtur gjithsej dy (2) takime të Gjyqit të Nderit për shqyrtimin e këtyre lëndëve.

Vërejtje: Lëndët e pasqyruara në tabelë përfshijnë lëndë që aktualisht ndonjëra prej tyre janë në procedim nga një organ në tjetrin. Për shkak të natyrës së procedurave është e pamundur që të nxirret në total bilanci i lëndëve, për shkak të qarkullueshmërisë së lëndës, varësisht nga faza procedurale në të cilën gjendet lënda e tillë.

4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional


Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës korrik-shtator 2020, ka akredituar 5 aktivitete.



Bazuar në rrethanat e krijuara si pasojë e pandemisë COVID 19 dhe pamundësinë e organizimit të tubimeve shkencore, Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional liron komunitetin e mjekëve nga obligimi i grumbullimit të së paku njëzet pikëve kredituese për vitin kalendarik 2020.

5. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Ri-licencim profesional gjatë periudhës korrik-shtator 2020, ka lëshuar licenca me kategoritë si në grafikun e më poshtëm:



6. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA për shkollim specialistik.

7. Këshilli Mbikëqyrës

Në periudhën kohore korrik–shtator 2020, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur dy (2) takime, ku është bërë shqyrtimi i vendimeve të Këshillit Drejtues-ligjshmëria e tyre konform akteve juridike të OMK-së dhe ligjeve në fuqi.

8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore korrik–shtator 2020, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe ka shqyrtuar katër (4) kërkesa për leje për hulumtim.

Kërkesat e shqyrtuara janë aprovuar nga Komisioni për Çështje Etike dhe aplikuesve u janë lëshuar lejet për hulumtim.

9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Në periudhën kohore korrik–shtator 2020, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar një (1) kërkesë për përkrahje financiare. Komisioni ka marrë vendim aprovues lidhur me kërkesën e pranuar.

10. Raporti financiar**10.1 Gjendja financiare – 30 shtator 2020**

1.0 Të hyrat:				
1.1 Të hyrat e shtyera nga 2019		304,543		
Të hyrat e shtyera nga 2019				304,543.00
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	TOTAL TM3
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:				
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	232,700.00	43,250.00	35,746	311,696
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	5,250.00	2,253.00	3,500	11,003
1.1.4 Licencimi	9,420	5,580	9,840	24,840
1.1.5 Të hyrat e tjera*	10,033	2,830	9,581	22,444
Të hyrat nga TM3	257,403	53,913	58,667	369,983
Të hyrat e shtyera nga 2019				304,543
TOTAL TË HYRAT				674,526

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	TOTAL TM3
2.1 Paga, medetje dhe kontributet pensionale	37,268	30,986	37,409	105,662
2.2 Material shpenzues	1,616.26	603	268	2,487
2.3 Reprerentacioni	282.20	151	476	910
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	4,699	-1,410	2,000	5,289
2.5 Shpenzimet e tjera*	4,810.00	7,848	7,725	20,382
2.6 Shpenzimet e Aeteve	1,878.00	102	980	2,960
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	6,600.00		9,000	15,600
TOTAL SHPENZIMET	57,153	38,279	57,858	153,290
BILANCI TM3	200,250	15,634	809	216,693
TOTAL BILANCI			521,236	

1.1.5* Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimili, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, Certifikatës për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera

2.5 *Faksimili, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Inventari, Shpenzimet e tjera operative.

2.7* Tek përkrahja për solidaritet përveq mjeteve të ndara për mjekët të cilët kanë lënguar nga ndonjë sëmundje, janë të përfshira edhe mjetet e ndara për familjet e mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasojë e infektimit me virusin COVID19, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues me nr. Ref. 53/20.

10.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës ka dhënë përkrahje financiare për Edukim të Vazhdueshëm Profesional gjatë tremujorit të tretë për Shoqatën e Kirurgëve Plastik, Rekonstruktiv dhe Estetik të Kosovës në vlerë prej 2,000.00€.

10.3 Prokurimi

Gjatë periudhës kohore korrik-shtator 2020, u zhvilluan tre procedura të hapura të prokurimit:

Në muajin korrik u bë ftesa për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës për të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit për Përkthim dhe lektorim të materialeve të OMK-së. Si rezultat i kësaj ftese janë pranuar ofertë nga gjashtë operator ekonomik, ku përzgjedhja e operatorit ekonomik u bë sipas konformitet cilësor të shërbimit të ofruar, duke u mbështetur në arsyeshmërin e çmimit të ofruar dhe pasi që operatori ekonomik ka plotësuar të gjitha kërkesat në përputhshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit.

Në muajin gusht u bë ftesa për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së. Si rezultat i kësaj ftese u pranuan vetëm dy oferta nga operator ekonomik, dhe për shkak të mospërmbushjes së kushtit për zhvillim të procedurës së prokurimit, u bë anulimi i procedurës. Ftesa për Tender për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së u rishpall me Vendim të Këshillit Drejtues në muajin shtator, dhe kësaj rradhe procedura e prokurimit u zhvillua me sukses.

Gjithashtu, në muajin korrik, bazuar në ofertat të pranuar, është bërë furnizimi i zyrave të OMK-së me pajisje kondicioner.

11. Aktivitete të tjera

11.1 Shërbimi profesional

Me datën 06 gusht 2020, është bërë përzgjedhja për kandidatin e suksesshëm për pozitën Asistente Administrative pranë Komisioneve të Përhershme sipas konkursit publik të datës 06 korrik 2020.

11.2 Kongresi vjetor

Ndër aktivitetet kryesore që Oda e Mjekëve ka planifikuar të realizoj për vitin 2020 është Kongresi Mjekësor. Për shkak të respektimit të masave të marra mbrojtëse për parandalimin dhe trajtimin e virusit pandemik COVID 19, organizimi i Kongresit vjetor është shtyrë deri në heqjen e masave mbrojtëse të marra nga Qeveria e Kosovës.

11.3 Revista mjekësore e Odës së Mjekëve të Kosovës

Me propozim të Këshillit Drejtues në mbledhjen e kuvendit të OMK-së u morr vendim për themelimin e Revistës shkencore të Odës së Mjekëve të Kosovës.

Me datë 2 mars Këshilli Drejtues emëroi anëtarët e redaksisë së revistës, ku si rrjedhojë me datë 9 mars u mbajt takimi i parë i anëtarëve. Në takimin e parë u vendos që revista të jetë informative, e cila do të botohet dy herë në vit, për të cilën u propozua që numri i parë të botohet me datë 1 qershor. Për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID 19, botimi i revistës është shtyrë deri në stabilizim të situatës bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

11.4 Marrëdhënie ndërkombëtare

Me datë 26 shtator Oda e Mjekëve të Kosovës, ka marr pjesë në simpoziumin e 27-të të ZEVA (Odat e Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore). Simpoziumi është mbajtur në formë virtuale të organizuar nga Oda e Mjekëve të Maqedonisë së Veriut, ku temë kryesore ka qenë “Përballja me pandeminë Covid -19, sfidat dhe përvojat e vendeve të ndryshme”.

11.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së dhe Prokurori i OMK-së, ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Ekspertizat:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM3	Vendimet sipas urdhëresave të pranuar për periudhën TM3	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën TM3	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	0	0	0	1	1

12. Plani i veprimit për 2020

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të, mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha OPSH-të, dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet të fillon pas miratimit të marrëveshjes për vazhdimin e projektit të KSV/017 nga Kuvendi i Kosovës.
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK-ja drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahje financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Botimi i Revistës mjekësore.
- Përpilimi i buxhetit për vitin 2021.
- Mbajtja e takimit të Kuvendit të OMK-së.
- Organizimi i Kongresit vjetor i fokusuar në lëmin e Onkologjisë.